# DËSHMI ARKIVI

**A-443440**
VERSIONI 1

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Babai i Andy Burnham ndërron jetë pas betejës me Alzheimerin, kryeministri anulon angazhimet - Inform ohu siç duhet |
| ADRESA | `https://radar.al/babai-i-andy-burnham-nderron-jete-pas-betejes-me-alzheimerin-kryeministri-anulon-angazhimet/` |
| BURIMI | radar.al |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 14 shtator 2026, 14:31:18 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 14 shtator 2026, 14:05:00 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | c08169288f380d6411b069ea1cf73cdff0f16f23f3ab5810e194cefe48c6c512 |
| TEKSTI | 855295a6bd67b820e1d357d2ebd11f62d2c6512573c1541d3ee6924f93e6d342 |
| PAMJA | c964ba5f3919216c6ec88035830cc05270c21edaf6a7f898772a049bff60ab73 |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | 5718a0ebcbe0b5001eda1d48f84fdd7cef3c6ef38cfceaafb978750d32488d2a |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | e0b9829abbee6aeaf0cbfff89c7cd5e0dcc89e0fb08f67fff94e9a06c82fe2c5 |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/5718a0ebcbe0b5001eda1d48f84fdd7cef3c6ef38cfceaafb978750d32488d2a`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

BOTË

# Babai i Andy Burnham ndërron jetë pas betejës me Alzheimerin, kryeministri anulon angazhimet

SEPTEMBER 14, 2026



*Screenshot*

Babai i kryeministrit britanik Andy Burnham, Roy Burnham, ka ndërruar jetë pas një beteje të gjatë me sëmundjen e Alzheimerit. Lajmi është konfirmuar nga Downing Street, ndërsa kreu i qeverisë britanike ka anuluar të gjitha angazhimet e planifikuara për të hënën dhe të martën, pas humbjes së të atit.

" Kryeministri ka anuluar angazhimet për sot dhe nesër për shkak të ndarjes nga jeta të babait të tij, Roy", bëri të ditur një zëdhënës i Downing Street.

Roy Burnham, i cili ishte 86 vjeç sipas raportimeve, jetonte në një institucion kujdesi për shkak të sëmundjes së Alzheimerit. Gjendja e tij shëndetësore ishte bërë publike nga vetë Andy Burnham, i cili në muajt e fundit kishte folur hapur për ndikimin që sëmundja e të atit kishte pasur te familja dhe te vetë ai.

Kjo përvojë personale ka ndikuar edhe në qëndrimet politike të Burnham për reformimin e sistemit të kujdesit social në Britani. Ai ka folur vazhdimisht për vështirësitë me të cilat përballen familjet që kujdesen për të afërmit e prekur nga demenca dhe Alzheimeri, duke e cilësuar reformën e kujdesit social si një prej prioriteteve të tij.

Në një rrëfim emocional, Burnham kishte treguar më herët se babai i tij nuk ishte në gjendje ta kuptonte plotësisht se i biri ishte bërë kryeministër, për shkak të sëmundjes. Megjithatë, stafi i qendrës së kujdesit ku qëndronte Roy kishte organizuar një moment të veçantë pas hyrjes së Burnham në Downing Street, duke e vendosur babain e tij përpara televizorit për të parë pamjet e të birit. Për një çast, stafi mendoi se Roy e kishte kuptuar se kush ishte në ekran.

Vdekja e të atit ka bërë që Burnham të tërhiqet përkohësisht nga aktivitetet publike. Mes angazhimeve të anuluara ishte edhe një paraqitje e planifikuar në konferencën e Kongresit të Sindikatave Britanike (TUC) në Brighton.

Roy Burnham kishte punuar si inxhinier telefonik, ndërsa Andy Burnham është shprehur më herët se prindërit e tij, pavarësisht se nuk kishin ndjekur universitetin, e kishin mbështetur dhe nxitur atë dhe vëllezërit e tij për të ndjekur arsimin e lartë.

SHARE.

Demo

## Postimet e reja

Babai i Andy Burnham ndërron jetë pas betejës...
SEPTEMBER 14, 2026

Butrinti tërheq gjithnjë e më shumë turistë,...
SEPTEMBER 14, 2026

Goditi me grusht protestuesin e prangosu...
SEPTEMBER 14, 2026

Skema sesi IUTE zbras fitimin nga Shqipëria, që...
SEPTEMBER 14, 2026

## Mos e humb

AKTUALITET | SEPTEMBER 14, 2026

Skema sesi IUTE zbras fitimin nga Shqipëria, që ju merr konsumatorëve me interesa mbi 30%!

Vitin e kaluar Iute në Shqipëri pagoi 1.1 miliardë lekë ose 11.4 milionë euro shpenzime...

Skandal me sallamin në dyqanet Conad, thirrje konsumatorëve ta kthejnë mbrapsht

6 milionë euro të Startup Albania: Përfituesit, qokat dhe "problematikët"

Beralb fitoi 15 mln euro nga bakri shqiptar, por po helmon fshatra të tërë me ndotje

## Na ndiq

Facebook Instagram
YouTube TikTok




Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.